



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2024:189711
Datë: 03.12.2024
Numri i dokumentit: 06538444

C.nr 737/2024

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Dega në Deçan, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Bajram Cacaj, në çështjen juridike kontestimore të paditëses D.H.K. nga fshati L., K. D., të cilën me autorizim e përfaqëson M.B., avokate në D., kundër të paditurës Komuna e Deçanit, Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Deçan, me objekt kontesti kompensim nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, jashtë seancës, me datë 03.12.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET e tërhequr padia e udhëhequr nën shenjë C.nr.737/2024, e datës 05.07.2024, e paraqitur nga paditësja D.H.K. kundër të paditurës Komuna e Deçanit, Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensim nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit.

A r s y e t i m

Paditësja me datë 05.07.2024, ka parashtruar padi kundër të paditurës, për kompensim nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit duke u bazuar në Vendimin e Qeverisë së Kosovës numër 01/33 të datës 29.08.2008 dhe aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës KO 79/23 të datës 24.01.2024.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të padisë pasi ka gjetur se e njëjta në propozimin e saj (në petitum) nuk përmban kërkesë të qartë në pikëpamje të kërkesës kryesore, me aktvendimin e datës 22.10.2024 paditëses, konkretisht të autorizuarës të saj, i është kthyer padia në plotësim, që në afat prej 3 (tre) ditësh ta plotësoj padinë në aspektin objektiv, konkretisht me përcaktimin e qartë të periudhës kohore dhe lartësisë së kërkesës për të cilën kërkohet kompensimi, konform nenit 99.2 dhe 102 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Me nenin 99.2 të LPK përcaktohet se: *“Parashtruesat duhet të jenë të kuptueshme dhe të përmbajnë çdo gjë që nevojitet dhe e mundëson veprimin sipas tyre. Ato duhet të përmbajnë sidomos: emrin e gjykatës, emrin dhe mbiemrin (emërtimin e personit juridik), vendbanimin apo vendqëndrimin (selinë e personit juridik) e palëve, të përfaqësuesve të tyre ligjor apo me prokurë, po që se i kanë, objektin e kontestit, përmbajtjen e deklaratës dhe firmën e parashtruesit”*.

Ndërsa me nenin 102.1 LPK përcaktohet se: *“Kur një parashtrësë nuk arrin të jetë e kuptueshme dhe e plotë, siç kërkohet në paragrafin 2 të nenit 99, gjykata do ta thërrasë personin që e dërgon ta korrigojë ose ta plotësojë parashtrësën. Në një rrethanë të tillë, gjykata e udhëzon palën për korrigjimet dhe për plotësimet që do të zënë vend dhe e cakton një periudhe treditore për korrigjimin dhe për plotësimin e parashtrësës”.*

Paditësja pavarësisht se aktvendimin në fjalë përmes të autorizuarës të saj e ka pranuar me datë 25.10.2024 (fakt i cili vërtetohet nga fletëdërgesa për dorëzim personal) nuk ka vepruar konform vërejtjeve të dhëna nga gjykata me aktvendimin e lart cekur, përkundër faktit se gjykata të njëjtën e ka njoftuar me pasojat ligjore, konkretisht se padia e tij do të konsiderohet e tërhequr po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit ligjore.

Duke pas parasysh se paditësja nuk vepruar sipas vërejtjeve të gjykatës dhe konform dispozitës së nenit 102.3 të LPK e cila përcakton se: *“Do të konsiderohet se është tërhequr parashtrësja po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtrësja do të hidhet poshtë”*, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi dhe padinë e paditëses e konsideroj të tërhequr.

Nga të lartcekurat, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
Dega në Deçan
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.737/2024, datë 03.12.2024

GJYQTARI

Bajram Cacaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimi të te njëjtit në Gjykatën e Apelit të Kosovës, e nëpërmjet kësaj gjykate.